



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 5 datë 18/01/1995

**MBI  
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE DHE PERFITIMIN E  
PAAFTESISE PER MUAJIN NENTOR 1994.**

Në zbatim të Ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”, VKM Nr.453, dt.26.09.1994 “Për dhënie e ndihmës ekonomike”, VKM Nr.557, dt.21.11.1994 “Për një ndryshim në VKM Nr.453, dt.26.09.1994, VKM Nr.138, dt.31.03.1994 “Për kompesimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, VKM Nr.311, dt.11.07.1994 “Për përfitimin e paaftësisë, udhëzimeve Nr.14 dhe 15 të Ministrisë Punës, Emigracioni dhe Përkrahjes Sociale, udhëzimit Nr.1118/1 prot. , Këshilli i Bashkisë, i mbledhur sot me dt.18.01.1995, pasi shqyrtoi edhe relacionin e Seksionit të Mbrojtjes Shoqërore

**V E N D O S I**

1. Të miratohen masa e ndihmës ekonomike të plotë për çdo familje për muajin nëntor 1994 dhe për rastet e trajtimit maksimal si më poshtë :

**Max**

Familje me 1 antar	1.100 lekë	1.344 lekë
-- 2 --	2.100 lekë	2.955 lekë
-- 3 --	2.300 lekë	3.369 lekë
-- 4 --	2.550 lekë	3.783 lekë
-- 5 --	2.800 lekë	4.197 lekë
-- 6 --	3.050 lekë	4.611 lekë
-- 7 --	3.300 lekë	5.025 lekë

--	8	--	3.500 lekë	5.082 lekë
--	9	--	3.750 lekë	5.082 lekë
--	10	--	4.000 lekë	5.082 lekë
--	mbi 11	--	4.200 lekë	5.082 lekë

2. Për muajin nëntor 1994 të përfitojnë ndihmë ekonomike gjithsej 12.570 familje me një fond prej 28 milion lekësh nga të cilat :

- 1.me ndihmë të plotë 12.091 familje me një fond 27.4 milion lekë  
2.me ndihmë të pjesshme 479 familje me një fond 0.6 milion lekë

Për këto familje të jepet një fond prej 6.9 milion lekë për kompesimin e energjisë elektrike.

Detajimi jepet në tabelën e bashkëngjitur.

3. Të përfitojnë paaftësi 923 persona me një fond prej 1.495.244 lekë.  
4. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për përkujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar në masën 1.344 lekë.

- Vjollca Destani - njësia administrative Nr.10

5. Të përfitojnë ndihmë ekonomike si raste të veçanta :

Lerton Keta ndihmë e plotë për 1 antar njësia 1  
Ermal Kaceli ndihmë e plotë për 1 antar njësia 2  
Hasan Brari ndihmë e plotë për 1 antar njësia 8  
Artan Kasmi ndihmë e plotë për 1 antar njësia 10  
Edmond Struga ndihmë e plotë për 4 antarë njësia 6

6. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike 91 familje, të cilat nga verifikimi u konstatuan se ishin punësuar apo vetëpunësuar, në gjendje të mirë ekonomike, kanë makina, jashtë shtetit, dhënie adrese e rreme, mosparaqitje, kanë prona etj.  
Sipas pasqyrës bashkëngjitur.

7. Të mbeten në skemën e ndihmës ekonomike Gëzim Cullari dhe Natasha Çeka, pasi në motivacionin e dhënë në relacion ka gabuar administratoria e njësisë 4.
8. Për ato familje që gjendja e tyre është shumë e keqe dhe me të vërtetë nuk ndihmohen dhe nuk kanë lidhje me pjestarët e familjes që kanë jashtë shtetit të lihen në skemën e ndihmës ekonomike përkohësisht dhe të kontrollohen 3 – 4 herë në vit nga administratorët shoqërorë të njësive administrative.
9. Për familjet që kanë ardhur dhe vijnë nga rrethe të tjera të vendit dhe pretendojnë që të marrin ndihmë ekonomike dokumentat e marra në rrethet e tyre ti siglojnë në seksionet përkatëse në rreth dhe ti noterizojnë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**